



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

PLANI PËR ZHVILLIM AKADEMIK **(2023-2025)**

Pejë,
prill 2023

Komisioni për Hartimin e Planit Zhvillimor Akademik 2023-2025:

Prof.asoc.dr. **Vehbi Miftari** – kryetar

Prof.ass.dr. **Alma Shehu**, anëtar

Prof.ass.dr. **Granit Kastrati**, anëtar

Prof.ass.dr. **Dardane Nallbani**, anëtare

Përmbajta:

Përmbledhje ekzekutive.....	5
HARTIMI I PIZHA.....	8
I.1. Përkufizimi i zhvillimit akademik.....	8
I.2. Filozofia e UNHZ-së për zhvillim akademik.....	8
I.3. Rëndësia e Planit për Zhvillim Akademik (PZHA).....	8
I.4. Vizioni dhe misioni i PZHA-së.....	8
I.5 Identifikimi i nevojave të personelit për zhvillim profesional.....	9
I.6. Plani Individual për Zhvillim Akademik.....	9
II. PËRGJEGJËSITË PËR REALIZIMIN E PLANIT DHE RISHIKIMI.....	10
II.1. Përgjegjësitë e menaxhmentit.....	10
II.2. Përgjegjësitë e njësive akademike.....	10
II.3. Përgjegjësitë individuale.....	10
II.4. Rishikimi i planit.....	11
III. STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E PERSONELIT AKADEMIK.....	12
III.1. Mësimdhënia.....	12
III.1.1. Ekselencë akademike / Përmirësimi i cilësisë së mësimit.....	12
III.1.2. Zhvillimi profesional me metodologji bashkëkohore.....	14
III.1.3. Përdorimi i inovacionit dhe teknologjisë ne mësimdhënie.....	15
III.1.4. Profilizimi i mësimdhënësve.....	16
III.1.5. Zhvillimi i personelit të ri akademik.....	17
IV. KËRKIMET SHKENCORE DHE ARTISTIKE & BOTIMET.....	20
IV.1. Kërkimet shkencore artistike.....	20
IV.2. Botimet.....	22
IV.2.1. Revista e universitetit.....	23
IV.2.3. Publikimi i librave universitarë / monografive.....	23
V. QASJA NË PLATFORMAT ELEKTRONIKE.....	25
VI. ZHVILLIMI I STUDENTËVE.....	26
VI.1. Programet e shkëmbimit.....	26
VI.2. Zgjerimi i shkathtësive të komunikimit, viti i fundit i studimeve.....	27

VI.3. Rrjeti “Alumni”	27
VI.4. Hulumentimet me punëdhënësit mbi performancën e të diplomuarve.....	28
VII. NDËRLIDHJA ME TREGUN E PUNËS - ZGJERIMI I BASHKËPUNIMIT ME INDUSTRIJË.....	29
VII.1. Aktivitete ekstrakurrikulare	29
VII.2. Ndërlidhja e diplomës me tregun e punës	30
VII.3. Përfshirja e palëve të interesit.....	30

Përmbledhje ekzekutive

Plani për Zhvillim Akademik është hartuar duke mbështetur në këto dokumente themelore:

Statuti i UNHZ-së;
Plani Strategjik i Universitetit (2023-2026)
Raporti për zbatimin e strategjisë (2019);
Draft-planin e Zhvillimit të Personelit Akademik
Strategjia për Kërkime Shkencore dhe Artistike

Plani për Zhvillim Akademik do të rishikohet dhe plotësohet para fillimit të çdo viti akademik, nga njësitë akademike dhe nga Zyra për Zhvillim Akademik.

SHKURTESA

ISHA	Instituti për Shkencë dhe Arte
PZHA	Plani për Zhvillim Akademik
PIZHA	Plani Individraul për Zhvillim Akademik
PEVP	Plani Efektiv për Vlerësimin e Personelit
PFZHA	Plani i Fakultetit për Zhvillim Akademik
QE	Qendra për Ekselencë

HYRJE

Sfondi

Në maj 2017, Këshilli Drejtues i Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë miratoi Planin Strategjik Zhvillimor për Universitetin 2017-2022, i cili plan në objektiven e dytë parasheh përgatitjen e ‘Planit për Zhvillimin Akademik të personelit akademik të UHZ-së’. Në vitin 2020 Senati i universitetit e miratoi “Planin Zhvillimor Akademik”.

Në janar 2023, Këshilli Drejtues i Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë miratoi Planin Strategjik Zhvillimor për Universitetin 2023-2027, i cili në objektiven e dytë e parasheh përgatitjen e ‘Planit për Zhvillimin Akademik të personelit akademik të UHZ-së’.

Me vendim të senatit, në dhjetor 2022 u themelua grupi punues për hartimin e Planit të ri Zhvillimor Akademik, të cilit iu kërkua që ta harmonizonte PZHA-në me orientimet e reja strategjike të universitetit “Haxhi Zeka”.

Parimet themelore

Universiteti ka marrë përgjegjësi për krijimin e një mjedisi të punës, i cili ua mundëson anëtarëve të personelit akademik t’i zhvillojnë aftësitë e tyre dhe t’i përdorin ato për ta realizuar misionin dhe vizionin e universitetit “Haxhi Zeka”, si dhe orientimet e tij strategjike.

Plani për Zhvillimin Akademik ka qëllim identifikimin e aktiviteteve kryesore të zhvillimit të personelit, duke e harmonizuar atë me Strategjinë e tanishme Zhvillimore të universitetit. Ai i pasqyron në përpikëri nevojat e përgjithshme të zhvillimit individual të anëtarëve të personelit akademik, në veçanti për t’i përballuar ndryshimet.

Zhvillimi i vazhdueshëm dhe tejkalimi i sfidave, përmes Zhvillimit të Personelit Akademik synohet të rritet. Plani e mbështet përsosmërinë e praktikës akademike, përmes udhëheqjes, zhvillimit të aftësive profesionale, hulumtimit dhe mësimdhënies, duke mundësuar punën me personelin akademik në disa drejtime:

- Zhvillimi i personelit akademik / studentëve;
- Hulumtimeve dhe publikimeve;
- Krijimit të shkathtësive plotësuese & ndërlidhjes me tregun e punës.

HARTIMI I PIZHA

I.1. Përkufizimi i zhvillimit akademik

Zhvillimi akademik i personelit është plan i detajuar i masave dhe i aktiviteteve, i cili u ndihmon anëtarëve të personelit të universitetit që të zhvillohen profesionalisht dhe ta përmirësojnë cilësinë e punës së tyre. Ai krijon mundësi të barabarta për gjithë personelin akademik dhe i përfshin të gjitha kategoritë e tij.

I.2. Filozofia e UNHZ-së për zhvillim akademik

Universiteti “Haxhi Zeka” e trajton personelin akademik si njërin ndër burimet themelore të tij. Ai është i përkushtuar që t’i ndihmojë secilit anëtar të personelit që të zhvillohet profesionalisht. Universiteti u mundëson atyre zhvillim të vazhdueshëm akademik, duke e ditur se përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij zhvillimi janë studentët tanë, si dhe shoqëria.

I.3. Rëndësia e Planit për Zhvillim Akademik (PZHA)

Universiteti synon t’i identifikojë dhe t’i njohë në vazhdimësi nevojat e personelit për zhvillim profesional dhe t’u mundësojë atyre zhvillim të vazhdueshëm, në mënyrë që investimi në ta të krijojë përfitime për studentët dhe shoqërinë.

I.4. Vizioni dhe misioni i PZHA-së

Vizioni: Universiteti “Haxhi Zeka” synon të shndërrohet në qendër të rëndësishme të zhvillimit akademik, edukimit cilësor të studentëve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të personelit akademik.

Misioni: Universiteti “Haxhi Zeka” synon që ta ngrisë nivelin profesional të personelit akademik, nëpërmjet krijimit të mundësive të barabarta për zhvillim profesional, që të jenë konkurrues në arsimin e lartë evropian.

Universiteti nxit zhvillimin profesional të personelit. Përkushtimi i anëtarëve të tij ndaj vlerave të UNHZ-së dhe synimi i tyre për zhvillim akademik janë kusht thelbësor për përfitimin e përkrahjes. Ky përkushtim e rrit ndjeshëm praninë e universitetit në hapësirën e integruar evropiane të arsimit të lartë dhe i mundëson universitetit që ta përmirësojë në vazhdimësi cilësinë e formimit profesional të studentëve.

I.5 Identifikimi i nevojave të personelit për zhvillim profesional

Pas miratimit dhe jetësimit të Planit Efektiv për Vlerësimin e Personelit (PEVP), në fund të cdo viti akademik, strukturat menaxhuese të njësive akademike, së bashku me koordinatorin e Zyrës për Cilësisë, duhet t'i identifikojnë nevojat specifike të personelit, nevojat e identifikuar në PIZHA dhe PFZHA, të cilat nuk janë përmbushur e për të cilat stafi ka nevojë, nevojat e identifikuar në bazë të rezultateve të vlerësimit etj. Këto nevoja të identifikuar do të përfshihen në PFZHA për vitin e ardhshëm akademik. Njësitë akademike, në shtator do të mbajnë sesione informuese me secilin anëtar të personelit, për t'u ndihmuar atyre që, mbështetur në planin e tyre individual dhe në të gjeturat e MEVS-së, t'i identifikojnë nevojat prioritare dhe mundësitë për zhvillim akademik.

Çdo vit, para hartimit të Planit të Fakultetit për Zhvillim Akademik, universiteti do të mbajë Sesion për Planin e Zhvillimit Akademik (sesion njëditor, në nivel universteti), në të cilin anëtarët e personelit do të njihen me mundësitë e reja të cilat ofrohen për ngritje akademike, me ndryshimet e politikave të universitetit për përkrahje (sipas PZHA të rishikuar), ndryshimet në procedurat e përfitimit të përkrahjes etj., në mënyrë që anëtarët e personelit dhe drejtuesit e fakulteteve të kenë mundësi të hartimit të PFZHA-së në harmoni me politikat e universitetit dhe me mundësitë reale për përfitim të personelit për ngritje akademike.

I.6. Plani Individual për Zhvillim Akademik

Anëtarët e personelit inkurajohen që në fillim të çdo viti akademik ta paraqesin Planin Individual të Zhvillimit Akademik (PIZHA), i cili do të identifikojë: nevojat individuale për zhvillim profesional, t'i paraqesë specifikat afatshkurtra dhe afatgjata për zhvillim profesional, t'i paraqesë aktivitet kryesore të cilat duhet t'i plotësojë anëtari i personelit, të përcaktojë rezultatet të cilat do të arrihen dhe të cilat do ta ngrisin ndjeshëm cilësinë e punës së personelit akademik, si dhe të përcaktojë burimet e nevojshme. Duke e përkrahur Planin Individual Për Zhvillim Akademik, nëpërmjet të universiteti, ai përkrah zhvillimin e shkathtësive plotësuese të secilit anëtar të personelit, si dhe u mundëson atyre ngritje të vazhdueshme të karrierën e tyre akademike.

II. PËRGJEGJËSITË PËR REALIZIMIN E PLANIT DHE RISHIKIMI

II.1. Përgjegjësitë e menaxhmentit

Rektori i UHZ-së, në bashkëpunim me Prorektorin për Mësim, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore dhe Zyrën për Zhvillim Akademik, është përgjegjës për jetësimin e PZHA-së, si dhe për monitorimin e zbatimit dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve të personelit akademik. Prorektori për mësim koordinon punën për zbatimin e PZHA-së. Ai siguron që njësitë akademike e kanë planifikuar, hartuar, realizuar Planin për Zhvillim Akademik të njësisë përkatëse. Për nivelin e realizimit të planit në njësitë akademike Prorektori për Mësim i raporton Rektorit, së paku dy herë në vit.

Po kështu, së paku një herë në vit, për Planin Zhvillimor Akademik rektori mban takim me dekanët e njësive akademike, prodekanët për Mësim dhe koordinatorin e Zyrës së Cilësisë. Dekanët e njësive akademike hartojnë raport për nivelin e zhvillimit akademik të personelit, si dhe i paraqesin nevojat për veprime të reja. Objektivat e propozuara diskutohen pastaj me menaxhmentin e universitetit dhe, pas miratimit të tyre, bëhen pjesë e PZHA-së. Prorektori për Çështje Mësimore dhe Zyra e Cilësisë organizojnë sesione trajnimi për politikat e reja.

II.2. Përgjegjësitë e njësive akademike

Njësitë akademike janë përgjegjëse për hartimin e planit të njësisë për zhvillim akademik të personelit, prezantimin e tij para menaxhmentit të universitetit dhe zbatimin e tij, pas miratimit të tij nga menaxhmenti. Ato janë përgjegjëse për zbatimin me përpikëri të tij, dhe jetësimin e tij, sipas projeksonit buxhetor. Ato rishikojnë çdo vit PFZHA, diskutojnë me personelin akademik, i identifikojnë vështirësitë në zbatimin e tij dhe propozojnë politika për përmirësimin e mangësive. Ato janë përgjegjëse për përkrahjen e vazhdueshme të personelit akademik në synimin e përbashkët për arritjen e objektivave.

II.3. Përgjegjësitë individuale

Anëtarët e personelit inkurajohen që në fillim të çdo viti akademik ta paraqesin Planin Individual të Zhvillimit Akademik (PIZHA), i cili do të identifikojë: nevojat individuale për zhvillim profesional, t'i paraqesë specifikat afatshkurtra dhe afatgjata për zhvillim profesional, t'i paraqesë aktivitet kryesorë të cilat duhet t'i plotësojë anëtari i personelit, të përcaktojë rezultatet të cilat do të arrihen dhe të cilat do ta ngrenë ndjeshëm cilësinë e punës së personelit akademik, si dhe të përcaktojë burimet e nevojshme. Duke e përkrahur Planin Individual Për Zhvillim

Akademik, universiteti e përkrah zhvillimin e shkathtësive plotësuese të secilit anëtar të personelit, si dhe u mundëson atyre ngritje të vazhdueshme të karrierën e tyre akademike.

Në këtë plan përfshihen të gjitha aktivitetet të cilat ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, në zhvillimin profesional të anëtarëve të personelit dhe në profilizimin e tyre të mëtejme.

Anëtarët e personelit akademik duhet të reflektojnë vazhdimisht për të arriturat e tyre nga PIZHA paraprak, ta rishikojnë atë, të propozojnë ndryshime e plotësime, në mënyrë që të sigurohen se synimet e tyre për zhvillim akademik të arrihen.

Stafi akademik është përgjegjës para së gjithash për hartimin me kujdes të Planit Individual për Zhvillim Akademik (PIZHA), si dhe të sigurojnë që aktivitetet e parapara dhe të miratuara në Planin e Fakultetit për Zhvillim Akademik (PFZHA), do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së tyre akademike dhe zhvillimin në karrierë.

II.4. Rishikimi i planit

Plani për Zhvillim Akademik do të rishikohet dhe plotësohet para fillimit të cdo viti akademik, nga Zyra për Zhvillim Akademik. Prorektori për Çështje Mësimore, në bashkëpunim me koordinatorët e njësive akademike propozon Senatit të UHZ-së ndryshimet / plotësimet në politikat akademike për vitin vijues akademik.

III. STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

III.1. Mësimdhënia

Përmirësimi i cilësisë së mësimi është prioriteti strategjik i UHZ-së (Shih: Plani Strategjik 2023-2026). Stafit akademik aftësohet në vazhdimësi për mësimdhënie cilësore. Në PIZHA mësimdhënësit planifikojnë aktivitete vjetore, nëpërmjet së cilave do t'i zgjerojnë kompetencat e veta profesionale dhe pedagogjike, si dhe do ta ngrënë cilësinë e mësimdhënies. Ajo do të mbështetet kryekrejt në metodologji bashkëkohore, të përputhshme me synimet e universitetit, njësisë akademike dhe programeve të studimit.

Zhvillimi i vazhdueshëm i personelit akademik nëpërmjet aftësimit të vazhdueshëm të tyre për përmirësimin e procesin e mësimi, është synim parësor i universitetit. Për këtë qëllim, ai do të hartojë Planin vjetor të universitetit për zhvillim akademik, i cili do të përfshijë aktivitete specifike për zhvillimin e personelit në përdorimin e metodologjive të reja të mësimdhënies.

III.1.1. Ekselencë akademike / Përmirësimi i cilësisë së mësimi

Plani mësimor dhe i mësimdhënies parasheh se ndryshimi shtrihet në kulturën dhe praktikën e ekipeve dhe grupeve, departamenteve dhe fakulteteve, por mbështetur nga strukturat për të favorizuar mënyrat e punës që reflektojnë praktikën më të mirë dhe mbështetjen e ndryshimeve kulturore. Ky Plan pasqyron punën bashkëpunuese me kolegët akademikë brenda dhe jashtë institucionit, duke përfshirë profesorët, asistentët, studentët e doktoratës në të ardhmen, udhëheqësit. Ekipi i Zhvillimit Akademik do të punojë gjithashtu me shërbimet institucionale dhe me Unionin e Studentëve. Qëllimi i ekipit është të ofrojë një shërbim efikas, efektiv dhe transparent i cili është në gjendje të përgjigjet dhe të mbështesë nevojat individuale, fakulteti dhe institucionale në lidhje me zhvillimin e praktikave të mira të personelit akademik.

Para fillimit të vitit akademik universiteti organizon punëtori njëditore për personelin e ri mbi teknikat e mësimdhënies, të cilët po ashtu kanë rast të shprehin edhe aftësitë e veta për eksperiencat në mësimdhënie. Stafit më eksperiencë duhet të ndihmojë personelin junior në përgatitjet e syllabusëve, menaxhimin e orëve të mësimi/ushtrimeve, plotësimin e dokumenteve administrative, etj.

Përmirësimi i cilësisë së mësimi bazuar në metoda të avancuara të mësimdhënies, mbështetje e personelit në hulumtime dhe promovim të inovacionit për arritjen e objektivave të universitetit duke pasur në qendër studentin. Prandaj, janë të domosdoshme masat për

përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në radhë të parë për t'u dhënë mundësi studentëve të zhvillohen si qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, mendimtarë kritikë dhe të aftë në zgjidhjen e problemeve, që është edhe standarti i parë i Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (European Higher Education Area), së dyti përmirësimi i cilësisë së mësiminës është i nevojshëm në mënyrë që të përmbushen kërkesat e tregut me njerëz të dijes dhe të vlerave.

Masat / aktivitetet:

- Mbështetur në PIZHA dhe PFZHA, **Qendra e Ekselencës bën planifikim vjetor për organizim të trajnimeve** mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies;
- Në PIZHA, secili mësimdhënës parashihet **trajnim-in/et të cilat duhet ndjekur** për ta zgjeruar më tej mënyrën e mësimdhënies, duke e zgjeruar atë me mënyra kreative dhe bashkëkohore të mësimdhënies;
- Ristrukturim dhe rihvillim të programeve të studimit në funksion të zhvillimit të kompetencave të studentëve; Programe studimore të reja të përshtatura me kërkesat e tregut.
- Mësimdhënësi (sipas planifikimit të njësisë akademike dhe planit të universitetit) **realizon së paku një mobilitet akademik** gjatë vitit, në mënyrë që t'i prekë dhe t'i njohë metodologjitë e mësimdhënies të cilat zbatohen në universitete të tjera, si dhe t'i zgjerojë shkathtësitë e veta të mësimdhënies, nëpërmjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies (Shih: Mobilitetet);
- Mësimdhënësit realizojnë **aktivitete të përbashkët mësimdhënës – studentë** në procesin mësimor, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes aktive, ndërveprimin mësimdhënës-studentë dhe student-student (përfshirë edhe atë në vlerësim, sipas metodës “peer to peer”), si dhe zgjerimin e të menduarit kritik të studentëve.
- **Stimulimi i mësimdhënësve për veprimtari botuese** (botimi në revistën e universitetit/ revista të specializuara dhe botimi i librave universitarë), me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së ideve, por edhe të rezultateve shkencore të tyre në fushat e studimit, me qëllim përdorimin e përvojës, shkathtësive kërkimore dhe sidomos të rezultateve shkencore si mjet konkretizuese në punën me studentët.

Indikatorët matës:

- Universiteti ka aplikuar së paku për një projekt ndërkombëtar mbi metodat e reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Mësimdhënësit (fillimisht ata të cilët nuk kanë kaluar nëpër trajnime të tilla) kanë realizuar së paku një trajnim për metodologjitë e reja të mësimdhënies;
- Mësimdhënësi ka zhvilluar një mobilitet afatshkurtër ose afatgjatë gjatë vitit akademik;
- Mësimdhënësi ka botuar së paku një artikull në revista të specializuara (WoS, Scopus) dhe i ka përdorur rezultatet e kërkimit si mjet konkretizimi në procesin e mësimdhënies;
- Mësimdhënësi tashmë ka integruar një metodë të re të mësimdhënies (peer to peer ose tjetër) në procesin e mësimdhënies.
- Studentët kanë marrë pjesë në projekte hulumtuese ose kërkimore individuale së bashku me mësimdhënësit e tyre.

III.1.2. Zhvillimi profesional me metodologji bashkëkohore

Zhvillimi i vazhdueshëm i personelit akademik dhe përdorimi i metodologjive të reja në mësimdhënie është jetik për mësim cilësor. Për këtë qëllim, do të hartohet plani vjetor i universitetit për zhvillim akademik, i cili do të përfshijë aktivitete specifike për zhvillimin e personelit në përdorimin e metodologjive të reja të mësimdhënies.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, do të zgjerohet kompetenca profesionale dhe pedagogjike e mësimdhënësve, si dhe cilësia e mësimdhënies, e cila do të mbështetet kryekrejt në metodologji bashkëkohore, të përputhshme me synimet e universitetit, njësisë akademike dhe programeve të studimit. Synimi: zhvillimi i vazhdueshëm i personelit, me qëllim përvetësimin e shkathtësive pedagogjike, që nxisin ndërveprimin me studentët.

Masat / aktivitetet:

- Universiteti do të organizojë **trajnime të vazhdueshme** (së paku dy në vit) për personelin akademik mbi metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies. Këto trajnime parashihen në Planin Vjetor të Punës së Qendrës së Ekselencës, e cila është përgjegjëse për planifikimin dhe realizimin e tyre. Secili anëtar i personelit akademik do da ndjekë së paku një trajnim në vit për metodologjitë e reja të mësimdhënies;
- Universiteti nxit **pjesëmarrjen e personelit akademik në projekte** vendore dhe ndërkombëtare, të cilat kanë synim përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies. Universiteti do të identifikojë partnerë vendës e ndërkombëtare për projekte të përbashkëta / pjesëmarrje në projekte të përbashkëta dhe do të hapë thirrje për mësimdhënësit për pjesëmarrje në këto aktivitete (së paku tri thirrje në vit);
- Universiteti do të nxisë përfshirjen e aktiviteteve shkencore si pjesë të programit të lëndëve mësimore. Ai do të identifikojë dhe jetësojë aktivitete shkencore të cilat mund të zbatohen si pjesë të programeve mësimore;
- Universiteti, nëpërmjet Bibliotekës Universitare, çdo vit siguron literaturën mbi metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies. Biblioteka e universitetit do të identifikojë dhe blejë libra fizikë, libra elektronike dhe artikuj për metodologjitë e reja të mësimdhënies, si dhe do të krijojë qasje në platformat elektronike për këtë qëllim;
- Universiteti do të krijojë **kulturë dhe frymë bashkëpunuese dhe motivuese për studentët**. Fuqizimi i sistemit “peer to peer”;
- Universiteti do të zvogëlojë ndjeshëm raportin: mësimdhënës-student. Ai do të zbresë në: 1/25.

Indikatorët matës:

- Universiteti ka zhvilluar tri thirrje në vit për pjesëmarrje të personelit në trajnime mbi metodologjitë e reja të mësimdhënies;
- 70 % e mësimdhënësve kanë ndjekur së paku një trajnim në vit për metodologjitë e reja të mësimdhënies;

- 35 % e personelit kanë marrë pjesë në projekte të përbashkëta;
- Si rezultat i pjesëmarrjes në trajnime ose projekte të përbashkëta, 20 % e personelit kanë mundësi që të përfshijnë aktivitete shkencore në programin e lëndës;
- 100 % e personelit ka ndjekur së paku një trajnim në vit për metodologjitë e reja të mësimdhënies;
- Biblioteka ka siguruar çdo vit literaturë të re mbi metodologji bashkëkohore të mësimdhënies, së paku 15 tituj në vit mbi metodologjitë e mësimdhënies; 30 artikuj shkencorë dhe qasje në së paku një platformë;
- 78 % e personelit akademik do të jenë të përcaktuar qartë në karrierë, në vitin e parë dhe 95 % e tyre në vitin e dytë;
- Universiteti ka hartuar strategji (duke caktuar listë prioritare në bazë të përvojës së deritashme, kërkesave për avansim etj.) dhe ka hartuar plan për pjesëmarrjen e personelit, i cili nuk ka arritur ta përmbushë këtë detyrë në vitin paraprak.
- Universiteti i ka mundësuar 35% të personelit në vitin e parë dhe 40% në vitin e dytë që të marrë pjesë në projekte të përbashkëta për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies;
- Përmirësim për 50% i raportit profesor/studentë në vitin e parë.

III.1.3. Përdorimi i inovacionit dhe teknologjisë në mësimdhënie

Përdorimi i inovacionit dhe teknologjisë informative në mësimdhënie është prioritet strategjik i universitetit (Shih: Planin Strategjik 2023-2026). Sot teknologjia e informacionit ka prekur të gjitha sferat e shoqërisë duke e ndryshuar rrënjësisht stilin e jetesës. Tashmë shkathtësitë në TIC paraqiten si nevojë e domosdoshme për universitetet në mënyrë që t'u përshtaten shoqërisë, të përgatiten për sfidat e ardhshme dhe të përfitojnë nga mundësitë dhe përfitimet që sjell ajo.

Masat/aktivitetet:

- **Përdorimi i teknologjisë inovative në procesin e mësimdhënies.** Secili mësimdhënës do të paraqesë kërkesë për TI të nevojshme në PIZHA (softuerë, pajisje, qasje në platforma ...). Përkrahje e projekteve të vogla për zhvillim të softuerëve për punë me studentë (platformë online për punë me studentët);
- **Trajnime nga departamenti i IT-së mbi përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie.** Zyra e IT-së mban tri trajnime vjetore për përdorimin e teknologjisë në procesin e mësimdhënies. Secili mësimdhënës do të ndjekë së paku një trajnim në përdorimin e TI në mësimdhënie. Zyra bën planifikimin për vitin pasues dhe i njofton njësitë akademike me planin e trajnimeve;
- **Hartimi i projekteve të vogla për zhvillim të softuerëve për punë me studentë** (platformë online për punë me studentë etj.). Për lëndët të cilat kërkojnë aktivitete të studentëve në të shkruar, mësimdhënësit do të hartojë projekt për zhvillimin e një softueri për mësim ndërveprues me studentët;
- **Mësimi online, mësimi me ligjërues mysafirë dhe mësimi në distancë** – Universiteti do të bëjë të mundur ndërlidhjen e procesit të mëimit në klasë me mësues / studentë në

distancë. Parashihet që së paku një herë në semestër (por jo më shumë se tri herë gjatë semestrit) mësimdhënësit do të mbajnë mësim nga distanca (për shkak të mobiliteteve, pjesëmarrjes në konferenca etj.). Po kështu, do të mundësohet mësimi në distancë (virtual me mësimdhënës mysafirë (“guest lecturers”).

- **Digjitalizimi i përmbajtjes lëndore.** Përorimi i TI e lehtëson edhe kërkimin, gjetjen dhe përdorimin e literaturës ekejronike, lehtëson qasjen në informacion, ndërkohë që tekstet shkollore të shtypura nuk do të ishin më burim i vetëm për përdorim nga ana e studentëve. Universiteti do t’i pajisë sallat me kompjuterë dhe smartboards në klasa për mësim digjital. Njësitë akademike do t’i parashohin ligjëratat dhe ushtrimet për lëndët në të cilat ka ndërlidhje të programit me TI në sallat e pajisura me kompjuterë. Mësimdhënësit do të paraqesin kërkesë, do të hartojnë projekt të vogël dhe do ta jetësojnë ndërlidhjen e përmbajtjes së lëndës me teknologjinë informative në procesin e mësimdhënies.

Indikatorët matës:

- 75 % e mësimdhënësve i kanë identifikuar pajisjet e nevojshme për përdorim të TI në mësimdhënie;
- 75% e mësimdhënësve i kanë paraqitur kërkesat në PIZHA për ndërlidhjen e TI me përmbajtjen lëndore;
- 80 % e personelit në vitin e parë dhe 95% e tyre në vitin e dytë kanë marrë pjesë së paku në një trajnim në teknologji informative;
- 35 % e personelit kanë hartuar projekt për përdorimin e softuerëve ... për punë online të studentëve në procesin e mësimin;
- 75 % e mësimdhënësve i kanë identifikuar pajisjet e nevojshme për përdorim të TI në mësimdhënie;
- 75% e mësimdhënësve e kanë paraqitur kërkesat në PIZHA;
- Së paku një trajnim për mësimdhënie online një trajnim për mësimdhënie në distancë, planifikuar dhe realizuar nga Qendra për Ekselencë;
- Së paku dy salla në vitin e parë dhe katër të tjera në vitin e dytë do të jenë të pajisura me kompjuterë / smartboard, tableta... për studentët.

III.1.4. Profilizimi i mësimdhënësve

UHZ po e thëllon reformën drejt profilizimit dhe ristrukturimit, në funksion të zgjerimit të ofertës së tij akademike. Profilizimi nuk parasheh vetëm atë të programeve studimore, por edhe të vetë personelit akademik. Për këtë synim, universiteti do të ndërmarrë këto masa dhe veprime:

Masat / aktivitetet:

- **Projekte/trajtime për personelin ekzistues për profilizim;** Universiteti, nëpërmjet PIZHA dhe PFZHA, identifikon nevojat për profilizim të mëtejshëm të mësimdhënësve dhe do të krijojë hapësirë të nevojshme për realizimin e aktiviteteve/trajtimeve të cilat i shërbejnë këtij profilizimi. Së paku dy herë në vit do të hapet thirrja për projekte të vogla për profilizim për secilën njësi akademike dhe thirrja për pjesëmarrje në trajtime të

specializuara. Jo më pak se 20 anëtarë të personelit akademik mund të përfitojnë nga kjo mundësi;

- **Mbështetja e personelit të ri akademik për përfundimin e studimeve të doktoratës.** Në pajtim me politikat e universitetit për zhvillimin e personelit akademik, universiteti mundëson përkrah anëtarët e tij që t'i përmbyllin studimet e doktoratës, duke u mundësuar qëndrim (pa u shkëputur nga puna) për qëllime studimore doktorale në universitetin në të cilin i kryen studimet;
- **Mbështetja e personelit akademik për regjistrimin e programeve postdoktorale.** Universiteti i nxit dhe i përkrah anëtarët e personelit akademik që t'i regjistrojnë studimet postdoktorale, me qëllim profilizimi të mëtejshëm dhe specializimi në fushën nga e cila ka formim paraprak;
- **Orientimi për lëndët e programit sipas kualifikimit.** Universiteti krijon politika të qarta të shpërndarjes së personelit në programe studimi sipas formimit të personelit akademik, si dhe kujdeset që mësimdhënësit të orientohen në lëndët/programet për të cilat kanë formim akademik;
- **Botime shkencore nga fusha e ngushtë e formimit akademik.** Universiteti përkrah botimin e së paku një artikulli dhe maksimumi 3 artikuj për mësimdhënës nga fusha e ngushtë e specializimit të anëtarëve të personelit akademik në platformat WoS dhe Scopus (Shih: Botimet);
- **Aktivitete ekstrakurrikulare.** Universiteti, nëpërmjet Qendrës për Ekselencë dhe kërkesave të njëjësive akademike përkrah aktivitetet ekstrakurrikulare të cilat i shërbejnë personelit dhe studentëve të zhvillojnë dhe përdorin aftësitë dhe njohuritë e tyre në kontekste të ndryshme. Aktivitete ekstrakurrikulare do të jenë në shërbim të ngritjes së frymës së ndërmarrësisë, përmirësim të punës në grup, përmirësim të performancës akademike, etj.

Indikatorët matës:

- Së paku dy thirrje në vit për projekte të vogla, të cilat i shërbejnë profilizimit të mësimdhënësve;
- Së paku dy thirrje në vit për trajnime (organizuar nga Qendra për Ekselencë - QE), të cilat i shërbejnë profilizimit të mësimdhënësve;
- Së paku nga 2 punime nga secili anëtar i personelit nga fusha e ngushtë e formimit akademik;
- Së paku 2 aktivitete ekstrakurrikulare organizuar nga Qendra për Ekselencë.

III.1.5. Zhvillimi i personelit të ri akademik

Universiteti harton planin të veçantë për rekrutimin e personelit të ri akademik, si dhe i përcakton politikat për rekrutimin e tij. Çdo vit akademik, Prorektori për Mësim, në bashkëpunim me rektorin, do t'i marrë propozimet e njëjësive akademike për nevojat e personelit dhe, pasi t'i shqyrtojë ato, do t'ua prezantojë strukturave drejtuese të universitetit.

III.1.5.a. Kodi për Rekrutimin e Personelit Akademik

Universiteti harton **Kodin për Rekrutimin e Personelit Akademik**. Ky kod përcakton hapat e domosdoshëm që universiteti duhet t'i ndërmarrë për të krijuar ambient miqësor për kërkimet / hulumtimet shkencore dhe kulturën e punës në të cilën kërkuesit shkencorë çmohen, nxiten dhe përkrahen për kërkime të mëtejme dhe për arritjen e objektivave individualë në kërkimet shkencore.

Hapat e domosdoshëm që universiteti duhet t'i ndërmarrë për të përmirësimin e metodave të rekrutimit të personelit të ri, si dhe sistemin e vlerësimit, në mënyrë që të krijojë sistem të vlerësimi të personelit, të pranueshëm ndërkombëtarisht dhe ta mundësojë zhvillimin e personelit në karrierë, në mënyrë që ata të jenë konkurrues në tregun europian të punës;

Rregullimin e dokumenteve themelore të cilat e mundësojnë zhvillimin e vazhdueshëm të personelit, si dhe krijojnë parakushte për krijimin e një mekanizmi të fuqishëm të vlerësimit;

Lehtësirat të cilat i mundëson universiteti për ta nxitur mobilitetin ndërkombëtar të personelit dhe të studentëve, por edhe atë ndëruniversitar e ndërsektoria;

Mekanizmat për ndërlidhjen e formimit profesional të studentëve me tregun e punës dhe matjen e kënaqësisë së palëve të ndryshme të interesit me performancën e studentëve të cilët i mbarojnë studimet në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

III.1.5.b. Masat për ambientim

Universiteti harton plan për mikëpritjen e personelit të ri, si dhe ambientimin e tij me politikën, kulturën dhe metodat e mësimdhënies në universitet. Për këtë qëllim, drejtori i zyrës për çështje akademike, së bashku me prodekanët për mësim të njësisë akademike dhe zyrën e prorektorit për Mësim do të hartojë plan vjetor për ambientimin e personelit të ri akademik me politikën e universitetit. Akomodimi i personelit të ri është procesi i rëndësishëm pasi i informon ata me rolin në institucion, me filozofinë e UHZ-së dhe me atë se çfarë ai ofron.

Masat / aktivitetet:

Sesione parapërgatitore. Universiteti organizon sesione parapërgatitore për personelin e ri akademik për aspektin pedagogjik, didaktik, njohjen e metodologjisë së punës etj. Sesionet organizohen sipas specifikave të programit në të cilin anëtarët e personelit do të angazhohen.

- **Trajnimet.** Universiteti harton planin vjetor të trajnimeve. Secili anëtar i personelit, në planin individual të zhvillimit dt'i propozojë trajnimet kryesore për të cilat ai ka nevojë. Mirëpo, për personelin e ri akademik, disa trajnime do të jenë të domosdoshme. Prandaj, QE, në bashkëpunim me drejtusit e programeve dhe përgjegjësit për zhvillim akademik nëpër njësitë akademike do të hartojë Planin e trajnimeve për personelin e ri akademik. Disa nga trajnimet bazike, të cilat do t'i organizojë universiteti janë: *Mbështetja e inovacioneve në mësimdhënie, përdorimi i teknologjive të informacionit dhe të komunikimit metodat e mësimdhënies; mësimi nëpërmjet metodave të aplikuara (E rekomandueshme për personelin e ri, por edhe për personelin ekzistues) etj.;*
- **Punëtoritë.** Para fillimit të vitit të ri akademik dhe hyrjes në fuqi të kontratës së nënshkruar ndërmjet universitetit dhe anëtarit të ri të personelit akademik, universiteti mban një ose më shumë punëtori mbi mënyrën e organizimit të punës, metodologjitë e reja në mësimdhënie, përdorimin e TI në procesin e mësimit, shkathhtësitë e veçanta etj. Kësisoj,

universiteti synon t'i trajtojë sfidat dhe t'u japë përgjigje kërkesave të personelit të ri akademik për promovim të dijes dhe mësimdhënies cilësore. Drejtusit e programeve dhe përgjegjësit për zhvillim akademik nëpër njësitë akademike hartojnë planin e punës për anëtarët e rinj të personelit akademik, varësisht nga numri dhe profili i anëtarëve të rinj, të pranuar për vitin vijues akademik.

IV. KËRKIMET SHKENCORE DHE ARTISTIKE & BOTIMET

IV.1. Kërkimet shkencore artistike

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike luan rol thelbësor në performancën e UHZ-së (Plani strategjik 2023-2026, prioriteti 4). Rritja e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe krijimtarisë artistike ndihmon në zhvillimin e personelit akademik, duke i zgjeruar kompetencën e mësimeve dhe aftësinë e tyre për hartim e zbatim të projekteve kërkimore-shkencore dhe artistike. Përmirësimi i infrastrukturës për kërkime dhe themelimi i Institutit për Shkencë dhe Arte (ISHA) i shërbejnë ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve kërkimore të personelit akademik dhe të studentëve. Po kështu, e zgjeron rrjetin e bashkëpunimeve me universitete të tjera dhe zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Me qëllim të zhvillimit të veprimtarive kërkimore-shkencore dhe artistike, promovimit dhe zbatimit të projekteve kërkimore shkencore, UHZ ka funksionalizuar **Zyrën për Kërkime Shkencore** dhe ka themeluar **Insitutin për Shkencë dhe Arte (ISHA)**.

Masat / aktivitetet:

- **Pjesëmarrja në konferenca shkencore vendëse dhe ndërkombëtare** – Universiteti ofron ndihmë financiare për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, të listuara në Scopus dhe Web of Science. Universiteti do ta rrisë buxhetin për veprimtari kërkimore shkencore. Secili anëtar i personelit akademik mund të përfitojë mbështetje financiare për pjesëmarrje në 1 konferencë ndërkombëtare në vit;
- **Organizimi i së paku një konference** në fushat në të cilat organizohet mësimi në Universitetin e Pejës. Kjo nxit punën kërkimore dhe mundëson prezantimin e të arriturave shkencore të personelit;
- **Qasja në sistemin informativ kërkimor (KRIS)** – Universteti mundëson qasje të në sistemin informativ të Kosovës për kërkime shkencore;
- **Mbështetja financiare për projekte të vogla kërkimore** - Universiteti përkrah 5 projekte të vogla kërkimore në vit, në bazë të thirrjes për personelin akademik (dy thirrje në vit, në fillim të secilit semestër). Secila njësi akademike mund të përfitojë mbështetje financiare për 1 projekt të vogël kërkimor në vit;
Çmimi “Hulumtues i vitit” – çdo vit akademik universiteti ia ndan çmimin “hulumtues i vitit” një anëtar të personelit akademik nga secila njësi akademike (në vlerë 500 euro), nëse gjatë atij viti ai/ajo kanë arritur rezultate të theksuara në hulumtime dhe/ose kërkime shkencore;

- **Çmimi “Punimi më i mirë i vitit”** dhe **“Vepra më e mirë artistike e vitit”** i ndahen një anëtarit të personelit nga secila njësi akademike (200 euro), nëse dëshmojnë rezultate të larta në punimet e publikuara ose në krijimtarinë artistike;
- **Aktivitete shkencore:** universiteti organizon edhe disa aktivitete të tjera, varësisht nga plani i punës së njësisë akademike/universitetit, siç janë simpoziumet; tryezat e rrumbullakta; punëtoritë e ndryshme; trajnimet dhe koncertet;
- Instituti për shkencë dhe Arte (ISHA) do të planifikojë dhe ofrojë infrastrukturën e domosdoshme për veprimtari të mirëfilltë kërkimore-shkencore e artistike dhe ndërmerr aktivitete për zhvillimin e laboratorëve hulumtues: rritjen e numrit të kërkimeve/projekteve aplikative; projektet e përbashkëta studimore dhe hulumtuese; pjesëmarrjen e personelit në hartimin e planeve të biznesit; dizajnimin e strategjisë së marketingut, në funksion të zhvillimit të personelit akademik.
- **Pjesëmarrja e përbashkët mesimdhënës -studentë në kërkimet shkecore.** Me qëllim të përkrahjes, aktivizimit, rritjes së bashkëpunimit dhe përfshirjes së studentëve në kërkime shkencore UHZ nxit dhe përkrah punën e ëpërbashkët kërkimore mesimdhënës- studentë. Universiteti ndihmon qasjen e tyre në institucione të rëndësishme për punë kërkimore – shkencore (Instituti i statistikave të Kosovës, Instituti Bujqësor i Kosovës etj.). Në bashkëpunim me mesimdhënësit, studentët hartojnë dhe zbatojnë projekte të skemave të financimit të veprimtarive shkencore dhe artistike vendëse dhe ndërkombëtare. Po kështu, ata përfshihen në projekte të përbashkëta hulumtuese ndërkombëtare. Umioversiteti, më tej, themelon revistën shkencore të universitetit dhe gazetën e studentëve, si mundësi për paraqitjen e të arriturave shkenore të mesimdhënësve dhe studentëve, pjeëmarrës në projekte shkencore ose hulumtuese. Për ta nxitur këtë llojveprimtarie, universiteti siguron licencë për programe softuerike, të nevojshme për këkrimet e përbashkëta, si dhe i pajisë laboratorët me pajisje të nevojshme për punë kërkimore-shkencore.
- Zhvillimi i **projekteve të përbashkëta hulumtuese me ndërmarrësinë** – Krahas projekteve të përbashkëta: mesimdhënës – studentë, stimulohet edhe bashkëpunimi mesimdhënës – ndërmarrës, ose mesimdhënës – studentë- ndërmarrës. Zyra për Hulumtime Shkencore harton politika që përfshihen këto dy kategori në projektet shkencore të financuara nga UHZ-ja.

Indikatorët matës:

- 83,500.00 euro nga buxheti i UHZ-së për kërkime shkencore për vitin 2023;
- Së paku 60 artikuj të personelit akademi në platformat SCOPUS dhe WoS;
- Së paku 30% e personelit të rregullt akademik merr pjesë në konferenca shkencore/artistike ndërkombëtare gjatë vitit 2023. 89% e tij merr pjesë deri në vitin 2027, nga të cilët 67% e tyre merr pjesë në konferenca shkencore të financuara nga UHZ-ja;
- 5 projekte të vogla shkencore (nga një për secilën njësi akademike), të financuara i financiar për secilën njësi akademike;

- 5 çmime “Hulumtues i vitit”;
- 5 punime të shpallura si “Punimi më i mirë i vitit”;
- Secili anëtar i personelit akademik merr pjesë në, së paku, njërin nga aktivitetet shkencore: trajnime, seminare, punëtori, simpoziume, tryezav të rrumbullakëta;
- 20% e anëtarëve të personelit akademik zhvillojnë punë kërkimore në bashkëpunim me universitete kombëtare;
- 20% e anëtarëve të personelit akademik realizojnë punë kërkimore në bashkëpunim me universitetet ndërkombëtare;
- 60% e anëtarëve të personelit akademik realizojnë punë kërkimore në bashkëpunim me kolegët e brendshëm;
- 50% e anëtarëve të personelit akademik zhvillojnë punë kërkimore në bashkëpunim me studentët. Së paku dhjetë (10) projekte kërkimore shkencore realizohen nga mësimdhënësit në bashkëpunim me studentët;
- 20% e anëtarëve të personelit akademik realizojnë punë kërkimore aplikative;
- 80% e anëtarëve të personelit akademik i përfshirja punimet e veta shkencore në programet e lëndëve;
- 14% e anëtarëve të personelit akademik merr pjesë në koncerte ndërkombëtare;
- 14% e anëtarëve të personelit akademik dhe e studentëve merr pjesë në festivale ndërkombëtare;
- 5 projekte të përbashkëta (aplikative) me ndërmarrësinë;
- Marrëveshje bashkëpunimi me ISK dhe IBK

IV.2. Botimet

Në *Planin Strategjik 2023–2026*, UHZ-ja parasheh ndarjen e fondeve për botime shkencore. Rritja e mëtejme e numrit të artikujve shkencorë të personelit të brendshëm akademik të Universitetit të Pejës, ëshët prioritet strategjik i universitetit. Botimi i tyre rrit konkurrueshmërinë dhe ndikon në ndërkombëtarizimin dhe ngritjen e cilësisë së punës në universitet. Aty, UHZ-ja parasheh ndarjen e fondeve për botime shkencore.

Prorektori për Mësim, në bashkëpunim me Zyrën e Cilësisë, i këshillon anëtarët e personelit akademik dhe studentët dhe u ndihmon atyre që rezultatet e fituara t'i publikojnë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, nëpërmjet botimit të artikujve shkencorë, pjesëmarrjes dhe prezantimit në konferenca shkencore, komunikimit në forume shkencore, botimin e monografive etj.

IV.2.1. Revista e universitetit

UHZ në *Planin për Zhvillim Strategjik* ka paraparë themelimin e revistës së specializuar dhe të gazetës së studentëve. PZHA-ja e rithekson domosdoshmërinë që universiteti të zhvillojë kapacitete për themelimin, redaktimin dhe indeksimin e revistave të specializuara të njësive akademike. Fillimisht do të themelohet një revistë në nivel universiteti. Më vonë, secila njësi akademike mund ta themelojë revistën e saj të specializuar.

Universiteti merr vendim për themelimin e revistës së specializuar. Ai emëron këshillin redaktues të revistës. Prorektorja për Mësim, në bashkëpunim me këshillin redaktues angazhohet për indeksimin e saj në platforma të fuqishme (“EBSCO”, “Worldcat”) brenda tri viteve të para, ndërsa edhe në “Web of Science” dhe “Scopus”, deri në vitin e pestë pas miratimit të PZHA.

IV.2.2. Publikimet në revista të indeksuara me faktor ndikimi – FN

Sipas Statutit të Universitet, për secilën thirrje akademike kërkohet një numër i caktuar i artikujve shkencor në revista të indeksuara në platforma ndërkombëtare, kështu që stafi i universitet inkurajohet që të botojë artikuj shkencorë në revista të indeksuara kredibile ndërkombëtare me *faktor ndikimi* (IF), Web of Sciences Core Collection (Clarivate Analytics) ose SCOPUS (Elsevier).

Më qëllim të mbajtjes së personelit akademik të njoftuar më përditësimet nga këto revista si dhe mënyrën e qasjes në këto revista, universiteti organizon sesione informues të rregullta vjetore për personelin akademik, si dhe individuale nëse është e nevojshme. Zakonisht këto sesione janë të hapura për të gjithë, por me theks të veçantë për personelin e ri akademik. Universiteti për të gjitha rastet ku kërkohet mbështetje financiare për publikime në platformat e mësipërme do ta përkrahë stafin akademik sipas rregullores për veprimtari kërkimore – shkencore dhe artistike.

Pritshmëria nga stafi akademik është që secili departament, përveç publikimeve tjera dhe pjesëmarrjeve në konferenca, të publikojë të paktën një artikull shkencor me rezultate burimore në ndonjërin nga revistat e indeksuar në platformat e lartshënuara brenda vitit.

IV.2.3. Publikimi i librave universitarë / monografive

Universiteti, nëpërmjet Këshillit të Botimeve, do t’i adresojë nevojat e njësive akademike për libra universitarë/monografi, të cilat do të përdoren si literaturë themelore ose ndihmëse në programet e akredituara mësimore. Prorektorja për mësim, në bashkëpunim me Këshillin e Botimeve do të hartojnë plan për përmbushjen e nevojave të programeve studimore me literaturë themelore.

Në tri vjetët e para librat / monografitë të cilat do të përkrahen për botim duhet të jenë të përfshira si burime themelore në programet e lëndëve dhe duhet të përkojnë me qëllimet e programit.

Indikatorët matës:

- Numri i punimeve shkencore të publikuara nga personeli akademik (89 % në WoS dhe Scopus deri në vitin 2027);
- Numri i punimeve shkencore të personelit akademik të financuara nga UHZ (67 %);
- Së paku 5 libra universitarë (së paku dy libra në FB dhe një libër në fakultetet e tjera) do të përkrahët për botim gjatë vitit akademik
- Revista e botuar brenda vitit 2024;
- Gazeta studentore e botuar brenda vitit 2023.

V. QASJA NË PLATFORMAT ELEKTRONIKE

Duke marrë parasysh rëndësinë e kërkimeve shkencore dhe artistike, qasja në platformat elektronike do të përmirësojë cilësinë e tyre dhe do të motivojnë personelin për angazhim më të madh. Në dy vjetët e ardhshëm, universiteti do të krijojë qasje në këto platforma e Kosovës për kërkime shkencore:

- Qasja për personelin akademik në platformën KRIS
- **Qasja në databaza ndërkombëtare (ELSEVIER)**, e cila mundëson pajisjen me njohuri në fusha specifike. Kjo databazë krijon mundësi të jashtëzakonshme për qasje në burime kredibile shkencore dhe, rrjedhimisht, në formimin profesional të personelit akademik;
- **Qasja në biblioteka digjitale** – bibliotekat digjitale janë një mundësi e shkëlqyer për të krijuar qasje në burime elektronike. Qasja në bibliotekat, sikur janë: JSTOR, Cambridge Journals online, Edëard Elgar publishing Development Studies and Environment – e-books; IOPSCIENCE, e-Duke Journals Scholarly Collection etj., krijon mundësi pasurimi të literaturës dhe përfshirje të tyre në programet e lëndëve;
- Krijimi i ORCID (Open Researcher and Contributor Identifier)

Indikatorët matës:

- 100% e personelit me qasje në platformën KRIS;
- Në vitin akademik 2023/24 univesiteti siguron qasje në databazën ndërkombëtare (ELSEVIER);
- Gjatë vitit akademik 2023/2024, universiteti u mundëson të gjithë anëtrëve të personelit akademik qasje në së paku 15 (pesë) bibkioteka online;
- Deri në fund të vitit akademik 2023/2024, universiteti sigurohet që 100% e personelit akademik tashmë e kanë ORCID.

VI. ZHVILLIMI I STUDENTËVE

VI.1. Programet e shkëmbimit

Programet për shkëmbimin e studentëve mundësojnë që studentë të universitetit “Haxhi Zeka” të studiojnë për një kohë në njërin nga institucionet partnere të institucionit. Ato u japin studentëve të UHZ-së mundësi për të studiuar në një vend dhe në një mjedis tjetër, duke provuar historinë dhe kulturën e një vendi tjetër. Programet e shkëmbimit ndërkombëtar janë gjithashtu efektive për t’i sfiduar studentët për të zhvilluar një perspektivë globale. Pjesëmarrësit e këtij programi e financojnë pjesëmarrjen e tyre përmes bursave që mbulojnë këtë aktivitet (Erasmus, CEEPUS etj.), fondit të ndarë nga Këshilli Drejtues i UHZ-së ose vetëfinancimit.

Masat / aktivitetet:

- UHZ do të ofrojë programe studimi në gjuhën angleze në të gjitha nivelet, për të hapur mundësinë e realizimit të programeve të shkëmbimit.
- UHZ krijon kushte për akomodimin dhe kujdesin e pjesëmarrësve të programit të shkëmbimit.
- Universiteti “Haxhi Zeka” do të identifikojë partnerë të gatshëm për t’i pranuar studentët tanë dhe për të dërguar studentët e tyre për një periudhë afatshkurtër (vizitë studimore ose universitet veror) ose afatgjatë (një ose dy semestrale).
- Universiteti “Haxhi Zeka” konkurren në programe të përbashkëta të Komisionit Evropian (p.sh. Erasmus Mundus etj.), për shkëmbim të studentëve së bashku me partnerët e universitetit si dhe e zgjeron rrjetin e shkëmbimit me partnerët e atyre universiteteve.
- UHZ përcakton buxhet për përkrahjen e studentëve, i cili rritet vazhdimisht gjatë 5 vjetëve të para, duke u bazuar me rritjen e shkëmbimit të studentëve;
- Universiteti “Haxhi Zeka” krijon mekanizmat e njohjes së rezultateve të pjesës së studimeve të mbaruar jasht nga studenti, duke u mbështetur në marrëveshjen tripalëshe universiteti dërgues - studenti - universiteti pritës, në të cilën janë të definuara edhe pjesët programore me ECTS kredi të transferueshme;
- Gjatë procesit të akreditimit/riakreditimit të programeve, universiteti do ta parashohë një lëndë në vitin e tretë të studimeve në studimet themelore (BA), e cila do t’i aftësojë studentët për shkathhtësitë e buta (soft skills) dhe shkathhtësitë e tjera plotësuese, me të cilat ata do të aftësohen për tregun e punës, duke marrë formim të nevojshëm dhe shkathhtësi të domosdoshme për të qenë të përshtatshëm me nevojat e tregut të punës.

Indikatorët matës:

- Është përcaktuar njësia administrative e UHZ që merret me programet e shkëmbimit;
- Është përcaktuar buxheti nga Këshilli Drejtues i UHZ për këtë qëllim;
- Së paku 10 marrëveshje me universitetet partnere për programet e shkëmbimit;

- Së paku 5 projekte të fituara nga Komisioni Evropian dhe programet e ndryshme të BE që përfshijnë programet e shkëmbimit;
- Së paku 20 studentë të dërguar në programe afatshkurtra të shkëmbimit - mobilitete;
- Së paku 10 studentë të dërguar në programe afatgjate të shkëmbimit;
- Së paku 5 studentë të pranuar në programe afatshkurtra të shkëmbimit;
- Së paku 4 studentë të dërguar në programe afatshkurtra të shkëmbimit;

VI.2. Zgjerimi i shkathtësive nëpërmjet trajnimeve shtesë

Zgjerimi i shkathtësive të studentëve nëpërmjet aktiviteteve ekstrakurrikulare i përgatit studentët për periudhën kalimtare ndërmjet formimit akademik dhe tregut të punës, duke i bërë ata më konkurrues. Universiteti organizon trajnime të ndryshme për t'i zhvilluar shkathtësitë e studentëve, si pjesë e përfitimit të shkathtësive të nevojshme për përfshirje në tregun e punës. Qendra e Ekselencës harton program të trajnimeve dhe disejnon plan konkret për përfshirjen e studentëve në trajnime. Studentët i nënshtrohen trajnimeve për t'i zhvilluar dhe përmirësuar shkathtësitë komunikuese, të udhëheqjes, menaxhimit në organizatë etj., duke u përgatitur për rolin e tyre të ardhshëm në organizata.

Masat / aktivitetet:

- **Programi i trajnimeve** – i hartuar nga Qendra e Ekselencës, në bashkëpunim me departamentet/programet e studimit;
- **Plani vjetor i trajnimeve:** QE harton plan vjetor të trajnimeve, mbështetur në programet e akredituara të studimeve dhe nevojave individuale të studentëve për trajnime.

Indikatorët matës:

- 15% e studentëve të vitit të fundit të studimeve në studimet themelore dhe 35% e studentëve në nivelin master përfshihen në trajnime;
- Numri i studentëve rritet në vitin e dytë. 25%, përkatësisht 45% e studentëve i ndjekin këto trajnime.

VI.3. Rrjeti “Alumni”

Në kuadër të Qendrës për Karrierën ekziston shoqata “Alumni”. Ajo mbledh rreth vetes të gjithë të diplomuarit në nivelin themelor ose atë master. Shoqata është krijuar nga nevoja për t'i forcuar marrëdhëniet midis universitetit dhe të diplomuarve. Përkushtohet që t'i shërbejë universitetit, të diplomuarve, studentëve dhe miqve të tyre. Qëllimi i këtij rrjeti është: bashkëpunimi mes gjeneratave të studentëve, për të krijuar krijimin e lidhjeve në mes të diplomuarve, studentëve, profesorëve dhe bashkësisë akademike; të krijojë bazën e të diplomuarve dhe të dhënat e tyre për të bërë të mundur depërtimin e tyre në tregun e punës; të organizojnë ngjarje, seminare, konferenca profesionale dhe të bëjë zhvillimin profesional të të diplomuarve etj.

Masat / aktivitetet:

- Funkcionalizimi i rrjetit të tanishëm të “alumni”;
- Rifreskimi i të dhënave ekzistuese me të diplomuarit dhe të regjistruarve;
- Mbajtja e kontakteve me studentët e diplomuar dhe kontaktimi i tyre përmes formave të ndryshme të pyetsorëve;
- Mundësia e regjistrimit në rrjetin “Alumni” te zyrtari për diploma në momentin e marrjes së diplomës;
- Përmes rrjetit “Alumni” të bëhet identifikimi i bizneseve ku punojnë të diplomuarit e dalë nga universiteti “Haxhi Zeka”.
- Përpilimi i listës së punëdhënësve;
- Hulumtime me punëdhënësit mbi performancën dhe ngecjet e të diplomuarve në aftësitë e tyre në punë.

Indikatorët matës:

- Numri i studenëve të punësuar nga rrejtji “Alumni”;
- Kërkesat nga punëdhënësit.

VI.4. Hulumtimet me punëdhënësit mbi performancën e të diplomuarve

Universiteti, në bashkëpunim me punëdhënësit, rrjetin “Alumni” dhe trupat këshillëdhënëse në secilen njësi akademike do ta vlerësojë performancën e të diplomuarve. Ai do të identifikojë nevojat e tregut të punës dhe vlerësojë performancën e të diplomuarve.

Masat / aktivitetet:

- Identifikimi i bizneseve në të cilat punojnë të diplomuarit e universitetit “Haxhi Zeka”- krijimi i një baze të të dhënave dhe i mekanizmave për përcjelljen e vlerësimit të performancës;
- Përpilimi i listës së punëdhënësve – krijimi i bazës së të dhënave për punëdhënësit me të cilët universiteti ka ose vendos bashkëpunim;
- Hulumtimi me punëdhënësit i performancës dhe ngecjeve të të diplomuarve në aftësitë e tyre në punë – identifikimi i mungesave në formimin akademik dhe shkathtësive për punë; identifikimi i nevojave për pëmirësimin e programeve të studimit – programeve të lëndëve;
- Diskutimi i këtyre rezultateve me trupat këshillëdhënëse dhe adresimi i tyre tek shefat e departamenteve/ udhëheqësit e programeve.

Indikatorët matës:

- Së paku 6 hulumtime të përbashkëta me tregun e punës gjatë një viti akademik;
- Së paku 6 angazhime të përbashkëta me punëdhënësit;
- Së paku 5 ngecje të identifikuara dhe të adresuara te personat përgjegjës në njësi akademike / universitet.

VII. NDËRLIDHJA ME TREGUN E PUNËS - ZGJERIMI I BASHKËPUNIMIT ME INDUSTRIJË

Lidhja më e mirë e programeve të studimit me tregun e punës është synim i universitetit. Si parim, ai buron nga Plani Strategjik 2023-2026. Aty, UHZ-ja ka përcaktuar mirë strategjinë e saj për përafrim të programeve të studimit me tregun e punës dhe të ndërmarrë masa për rritjen e punësueshmërisë së të diplomuarve të saj. Ndërlidhja e programeve më tregun e punës ndikon në zhvillim të qëndrueshem të universitetit/personelit akademik dhe për profilizimin e universitetit.

VII.1. Aktivitete ekstrakurrikulare

- **Puna praktike** - e detyrueshme për programet e studimit, në lëndët për të cilat kërkohet ndërlidhje e pjesës teorike me atë praktike;
- **Këshillim për përfshirjen e punës praktike në programet e studimit** - Trupat këshillëdhënse u rekomandojnë njësi akademike se për cilat lëndë është e domosdoshme puna praktike. Njësitë akademike bëjnë harmonizimin e programeve mbështetur në rekomandimet e tyre;
- **Rritja e numrit të ECTS-ve për punën praktike** - Programet e studimit përfshijnë numër më të madh të ECTS-ve për pjesën praktike. Së paku 5 ECTS sigurohen për punën praktike për programet, në të cilat puna praktike është e domosdoshme;
- **Zgjerimi i listës së partnerëve** relevantë të industrisë dhe i bashkëpunimit me ta për ta lehtësuar punën praktike, kërkimet shkencore dhe punësimin e studentëve. Zyra për Karrierë dhe Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ndërinstitucional identifikojnë partnerët e rinj dhe krijojnë bashkëpunim me ta.
- **Zgjerimi i bashkëpunimit** nëpërmjet projekteve të përbashkëta aplikative – Universiteti harton projekte të përbashkëta aplikative dhe merr pjesë në zbatimin e tyre;
- **Përfshirja e studentëve në hulumtime**, punë praktike, mbledhjen e të dhënave dhe krijimin e bazës së të dhënave për industrinë në rajonin e Dukagjinit – Hulumtimet e përbashkëta me studentët luajnë rol thelbësor në mbledhjen e të dhënave të rëndësishme mbi mënyrën e funksionimit të industrisë dhe mundësitë e bashkëpunimit me të. Po kështu, nga ky bashkëpunim krijohet bazë e qëndrueshme e të dhënave mbi industrinë në Rajonin e Dukagjinit;
- **Zhvillimin dhe akreditimin e programeve profesionale të nivelit 5**, duke ofruar trajnime për personat (stafi aktual i UHZ-së) që do të përfshihen në programet profesionale;
- **Aktivitete ekstrakurrikulare** për studentët për nxitje të frymës së ndërmarrësisë; përmirësim të punës në grup dhe përmirësim të performancës akademike, etj

Indikatorwt matës

- Së paku tri projekte të realizuara për njësi akademike;

- Së paku 25 studentë dhe 5 profesorë të përfshirë në projekte që synojnë mbledhjen e të dhënave dhe krijimin e bazës;
- Tri trajnime në vit për personelin e agazhuar në programe profesionale, të planifikuar dhe të realizuara nga Qendrën për Ekselencë.
- Së paku 10 lëndë (ose 30% e lëndëve) nga secila njësi për programet e kanë të obligueshme punën praktike;
- Së paku 10 bashkëpunimi të reja të përgjithshme në vit në nivel universiteti.

VII.2. Ndërlidhja e diplomës me tregun e punës

Universiteti “Haxhi Zeka”, nëpërmjet Bordit Industrial, do të lidhë marrëveshje me punëdhënësit për t’i përmbushur nevojat e profesionistëve të tyre të punës që kërkojnë aftësi të zgjeruara në punë. Programet dhe lëndët mësimore do të jenë të referuara si "arsim i bazuar në treg". Këto programe do të ndjekin strategjinë më të gjerë të regjionit, me pozicionim të bazuar në misionin e UHZ. Programet e tilla do të zhvillohen me anë të lëndëve të përfshira në planin akademik të studentit, që përfshijnë pjesë praktike të ndërlidhur me tregun e punës me qëllim për marrje të diplomës akademike. Të gjitha lëndët mësimore me përmbajtje të bazuar në treg, do të përfshijnë një plan vlerësimi për të dokumentuar të arriturat e studentëve.

Masat / aktivitetet:

- Identifikimi i nevojave të tregut në regjionin e Dukagjinit dhe në Kosovë për të diplomuar në nivelin themelor të studimeve dhe atë master;
- Identifikimi i programeve akademike të cilët kërkohen me tregun global të punës;
- Përgatitja e programeve adekuate të harmonizuara me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë duke e përfshirë edhe kontributin e Bordit Industrial të UHZ-së dhe të përfaqësuesve të tjerë të tregut të punës;
- Bashkëpunimi me Odën Ekonomike dhe organizata të tjera për përcaktimin e prioritetëve të tregut të punës në Kosovë.

Indikatorët matës:

- Së paku 15 pjesëmarrës nga ndërmarrësia në përcaktimin e kërkesave të tregut të punës për të diplomuarit nga fushat e caktuara në UHZ;
- Së paku 60% të të diplomuarve punësohen nga tregu i punës së regjionit të Dukagjinit;
- Numri i programeve të praktikës së përbashkët në harmoni me partnerët nga komuniteti i biznesit, me mundësi të punësimit të studentëve që i përshtaten kërkesave të tregut të punës.

VII.3. Përfshirja e palëve të interesit

Universiteti “Haxhi Zeka” përmes njësisë akademike deri me tani ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione arsimore të ngjashme brenda dhe jashtë Kosovës. Nënshkrimi i marrëveshjeve të tilla do të vazhdojë edhe në të ardhmen, ngase ndihmon në shkëmbimin e përvojave akademike në mes të personelit akademik dhe studentëve, e cila ndihmon drejtëpërdrejtë në ngritje të cilësisë. Bashkëpunimi me palët e tjera të interesit dhe

përfshirja e tyre në vendimarrje është politike e zbatueshme e universitetit “Haxhi Zeka”. Kjo është argumentuar edhe me themelimin e trupave këshillëdhënës në kuadër të të gjitha njësive akademike . Synim tjetër i universitetit tonë do të jetë bashkëpunimi me fondacione të ndryshme të cilat do të ndihmon edhe me shumë në realizimin e projekteve hulumtues në kuadër të fushave ekzistuese në Universitetet.

Masat / aktivitetet:

- Identifikimi i fondacioneve me të cilat mund të realizohen projektet te ndryshme me interes te dy anshëm;
- Kontaktimi dhe nënshkrimi i memorandumëve të bashkëpunimit;
- Përgatija e planeve të zbatimit nga të dyja palët.

Indikatorët matës:

- Së paku 5 marrëveshje të nënshkruara me universitete / palë të interesit;
- Së paku 5 projekte të realizuara në bashkëpunim me ta.

Kryesuesi e Senatit

Prof.dr. Armand Krasniqi – rektor

